

RAPORT INDIVIDUAL I KONSULTIMIT PUBLIK

1. Titulli i projekt aktit

Projektligji “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Kombëtar për Artin”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Kombëtar për Artin” synon krijimin e Fondit Kombëtar për Artin si një fond që funksionon plotësisht brenda kornizës ligjore të menaxhimit financiar publik. Kjo zgjedhje shmang krijimin e strukturave burokratike shtesë dhe siguron që fondi të jetë i mbikëqyrur, transparent dhe i integruar në proceset standarde të kontrollit financiar. Kjo mbështet parimin se fondi nuk është një organizëm autonom, por një instrument publik i kontrolluar nga shteti dhe i mbikëqyrur rreptësisht.

Objektiva kryesore të këtij projektakti janë:

1. Pasurimi i koleksioneve publike;
2. Mbrojtja dhe rikthimi i veprave me rëndësi historike e kulturore;
3. Nxitja e krijimtarisë artistike vendase dhe ndërkombëtare;
4. Ruajtja e trashëgimisë artistike për brezat e ardhshëm.

Projektligji është hartuar nga strukturat e Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

Procesi i konsultimit publik është realizuar nëpërmjet RENJKP, nga data 31.3.2026 deri në 28.4.2026, njëzetë (20) ditë të plota pune, proces gjatë të cilit nuk pati komente apo sugjerime lidhur me projektligjin.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Kombëtar për Artin”, ishin:

- Konsultimi përmes Regjistrit Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, RENJK (31.3.2026 - 28.4.2026).

Në RENJKP janë regjistruar 191 shikime dhe asnjë koment.

4.Palët e interesit të përfshira

Listoni të gjithë palët e interesuara, qoftë organizata apo individë, të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike përmes metodave të ndryshme të konsultimit, gjatë gjithë procesit të hartimit.

Përmendni gjithashtu numrin dhe strukturën e palëve të interesuara që morën pjesë në takime publike ose seanca të organeve këshilluese.

Specifikoni palët e interesuara që morën pjesë në grupin e punës për hartimin e aktit.

Nuk ka patur palë të interesuara, për të dhënë komente lidhur me ndryshimet që janë propozuar për këtë ligj.

5.Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Nga procesi i konsultimit të projektligjit, nuk ka patur komente.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi